



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot. Tiranë ___/___/2014
Nr. Dok. 201401285/6

Lënda: *Rekomandohet hapja e dosjes shëndetësore për të paraburgosurin D. Xh. dhe dërgimi i tij për një vizitë te mjeku specialist*

Drejtuar: Drejtorit të IEVP Peqin
Z. Fatos VELIU

I nderuar Z. Veliu,

Pranë Institucionit të Avokatit të Popullit ka paraqitur një ankesë shtetësja F. F., e cila na kanë përcjellë shqetësimin e saj për gjëndjen shëndetësore dhe sigurinë e djalit D. Xh. Më konkretisht ajo shpjegonte se, në takimin që kanë patur me D. ai i ka treguar se dy të paraburgosur nga Kukësi e kanë dhunuar fizikisht duke i thyer kockën e vetullës së majtë. D. ka kërkuar të kryejë një vizitë mjeksore por, kjo kërkesë nuk është realizuar.

Për verifikimin e kësaj ankese, një nga ndihmëskomisionerët e Institucionit të Avokatit të Popullit, ka kryer hetime në IEVP Peqin në datën 06.08.2014. Ndihmëskomisioneri ka marrë kontakt me të paraburgosurin D. Xh., mjekun e institucionit si dhe ka administruar fotokopje të disa dokumentave.

Në deklarinimin e tij me shkrim, D. Xh. është shprehur se, në datën 17.06.2014, pas një konflikti me shokun e dhomës A. Sh., është goditur prej tij në ballë me çekiçin që përdoret për të shtypur mishin. Një orë pas goditjes, D. ka patur gjakderdhje nga hundët dhe entje të syrit të majtë. Megjithëse ai ka kërkuar të marrë takim me mjekun e institucionit dhe të kryejë një vizitë mjeksore, kjo kërkesë nuk është realizuar. Pas interesimit të nënës së tij, ai është dërguar në Institutin e Veçantë Shëndetësor të Burgjeve në datën 30.07.2014 por, nuk ka kryer asnjë vizitë apo analizë mjeksore.

Nga kqyrja e raport shërbimit të datës 17.06.2014 rezulton se, D. Xh. është konfliktuar në dhomë me A. Sh. por, nuk shpjegohet dinamika e ngjarjes. Për këtë ngjarje është mbledhur Këshilli Disiplinor, i cili ka quajtur fajtor të paraburgosurin A. Sh. dhe i ka dhënë atij masë disiplinore "përrjashtim nga aktivitetet e përbashkëta për 20 ditë".

Nga kqyrja e Urdhërit të brendshëm Nr.2293, datë 30.07.2014 rezulton se, i paraburgosuri D. Xh. është shoqëruar në datën 30.07.2014 për në IVSHB

por, nuk është e mundur të sqarohet nëse ai ka kryer ose jo vizitë mjeksore, pasi mjeku i IEVP Peqin është shprehur verbalisht se nuk gjendet dosja shëndetësore e të paraburgosurit.

Referuar Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve, çdo i burgosur duhet të ketë dosjen e tij shëndetësore (neni 8). Çdo kontroll, duhet të dokumentohet në kartelën mjekësore të të burgosurit, e cila është pjesë e dosjes mjekësore të tij (neni 31/2).

Për sa më lart, bazuar në Nenin 63, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: "Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut" si dhe në mbështetje të Nenit 21/b të Ligjit Nr.8454 dt.04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit" (me ndryshimet përkatëse) ku përcaktohet se: "Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive."

J U R E K O M A N D O J M Ë:

Hapjen e dosjes shëndetësore për të paraburgosurin D. Xh. dhe dërgimin i tij për një vizitë te mjeku specialist.

Në bazë të Nenit 22 të Ligjit Nr.8454 dt.04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", lutemi të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor për qëndrimin dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi si dhe na dërgoni fotokopje të konstatimeve të mjekut specialist dhe rekomandimeve të tij.

Duke besuar në bashkëpunimin Tuaj,

AVOKATI I POPULLIT

Igli TOTOZANI

Në Mungesë dhe me Porosi

K O M I S I O N E R I

Arben SHKËMBI